



RENOFIX 202

GLET MASË NË BAZË GËLQERE PËR RRAFSHIM (PATINIM)

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Masë rrafshuese (glet masë) e rafinuar, jo hidrofobe, në bazë gëlqereje, për rrafshim (patinim). Përdoret për krijimin e sipërfaqeve të lëmuara mbi llaçet themelore. Përdoret për sipërfaqe të mureve të brendshëm, paraprakisht të suvatuara me llaç themelor (gips, gëlqere, çimento), si dhe pllaka gips kartoni. Mbi këtë material nuk preferohet ngjitja e pllakave.

PËRMBAJTJA:

- Gëlqere në pluhur
- Pluhur i bardhë mermeri
- Përbërës organikë <5%

VEÇORITË:

- Përpunim i mirë dhe efikas
- Sipërfaqe e lëmuar, e përshtatshme për shljafim
- Shkallë e lartë e difuzionit

PËRGATITJA E BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i thatë, i pastruar nga pluhuri, mbeturinat dhe sipërfaqet e lyera me ngjyra të shkëlqyera. Lagështia e bazamentit duhet të jetë nën 2.5% nga masa (sipas CM matjeve). Nëse në mur ekzistojnë fuga apo çarje të hapura, ato duhet paraprakisht të mbyllen. Llaçet themelore çimento - gëlqerore paraprakisht duhet të jenë tharë dhe të jenë të vrazhdë.

PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes Renofix 202 zbrazet në 12-13 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser dore derisa të fitohet masë homogjene. Pas përzierjes, materiali duhet të qëndrojë për 10 minuta. Më pas, përzihet sërish për një kohë të shkurtë.

PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT:

Materiali bartet me mistri çeliku / gletkele. Trashësia e shtresës duhet të jetë 1-3 mm. Për cilësi të lartë të sipërfaqeve, mund, sidomos të llaçet e vrazhda themelore pas tharjes së shtresës së parë, të vendoset edhe shtresa e dytë. Përzierja e freskët duhet të përdoret brenda 6 orëve. Gjatë tharjes kujdesuni për ajrosje të mjaftueshme. Sipërfaqet e pa rrafshuara që janë formuar gjatë përpunimit mund të rrafshohen me letër gryse me granulacion 180/220. Më pas, sipërfaqja është e gatshme për ngjyrosje. Mbështjellja me tapeta mund të kryhet vetëm pas tharjes së plotë të materialit. **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzierja me materiale tjera.



VËRREJTJE::

Përmban gëlqere të shuar. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla, lëkura të lahet me ujë të pastër ndërsa për sytë të kryhet kontrolli mjekësor.

PAKETIMI:

Në thasë letre nga 25 kg. që janë të mbrojtura nga lagështia.



DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 3 muaj.

Të dhëna teknike	
Numri i prodhimit	5319990620101
Shifra e prodhimit:	1202



RENOFIX 202

Thasë në paletë:	42
Struktura e llaçit:	Glet masë
Ngjyra:	E BARDHË
Sasia e nevojshme e ujit:	12-13 l./Thes
Trashësia e shtresës:	1-3 mm
Harxhimi:	1,5 kg/m ² për trashësi të shtresës prej 1 mm
Shënim:	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10):	ca 1000 kg/m ³
Përçueshmëria e nxehtësisë (EN 1745:2002):	0,3 W/mK
Kapaciteti i veçantë i nxehtësisë:	1 J/kg K
Vlera e pH:	ca 12
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):	1 N/mm ²
Reagimi gjatë djegjes:	F
MG (EN 998-1):	GP CS I W0

Udhëzime të përgjithshme:



Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjeni aktualitetin e të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: www.renova.com.mk si ose mund t'i kërkontë në sektorin e shitjes.



RENOVA PUTZ | www.renova.com.mk

RENOVA Xhepçisht, Tetovë, Makedonija | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | info@renova.com.mk
 RENOVA Gurëza, Ferizaj, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | renova_ferizaj@hotmail.com
 RENOVA Vorë, Tiranë, Shqipëri | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | renova.tirana@hotmail.com